



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3588 / prot
/1

Gramsh më 5 /09 /2023

P/V E N D I M

Nr. ___ dt. . 09.2023

PER

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2024-2026 PER BASHKINË GRAMSH TË RISHIKUAR”**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës __.09.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; neni 36 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzim plotësues nr. 06 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” me shtojcat plotësuese, si dhe materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Gramsh ;

ENDOSI:

1. Të miratojë projektin e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2024 - 2026, të Bashkisë Gramsh të rishikuar, sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026) bashkëlidhur dhe formateve të FPT bashkëlidhur si më poshtë :

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë GRAMSH

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimeve

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike

Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 9. Të dhënat e Programit

2-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetar i Bashkise dhe aparati i Bashkise.

3-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit
Xhulia GJINI



Kryetari i Keshillit te Bashkise
Enis Zani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 3588/2 Prot

Gramsh, më 15/09/2023

Lenda : DËRGOJMË P/VENDIMIN PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 PËR BASHKINË GRAMSH TË RISHIKUAR

Drejtuar: KËSHILLI BASHKIAK

KËTU

Te nderur Zotërinj!

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", neni 41 pika 1, neni 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 36 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV", Udhëzim plotësues nr. 08 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" me shtojcat plotesuese, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka hartuar projektin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pasqyrat përmbledhëse dhe relacionin shpjegues të tij.

Bashkangjitur po iu dërgojmë P/Vendimin pasqyrat dhe relacionin shpjegues të programit buxhetor afatmesëmte për vitet 2024-2026 të rishikuar, për tui vënë në dispozicion anëtarëve të komisionit të ekonomisë pranë Këshillit Bashkiak.

Jeni të mirëpritur të dërgoni sygjerimet apo vërejtjet tuaja mbi këtë projekt buxhet afatmesëm me qellim përshpejtimin e procedurave për miratimin e këtij projekt buxheti afatmesëm në mbledhejn e rradhës së Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

KRYETARI
BESTON AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

№ 3588 prot.

Gramsh, më 15/08/2023

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2024 - 2026

1. HYRJE	
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT E FETIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR.....	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE)	8
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	8
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT	9
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT (1-2 FAQE)	9
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË.....	9
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	10
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2024-2026	14
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË GRAMSH NË VITET 2024-2026	15
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë GRAMSH për vitet 2024-2026	15
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë/Qarkut [EMRI] për periudhën 2024-2026.....	20
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	25
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	26
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	33
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....	49
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	82
5.1.4 Të Dhëna mbi Programin	85

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë GRAMSH	15
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	17
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike	20
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....	21-24
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	26-32
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	33-48
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	49-82
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit.....	82-84
Tabela 9. Të dhënat e Programit	85-97

Lista e Shkurtimeve

- PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT – Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT – Instituti i Statistikave
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojës dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin

e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisve vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësisia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arrijtet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasi të produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standardeve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kolonë të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zëmrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektiveve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tërvanet e njësive së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV dhe përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllim konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë (1-2 faqe)

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Gramsh gjendet në qendër të vendit tonë. Ajo përbëhet nga 10 NjA: Gramsh, Pishaj, Poroçan, Kukur, Lënie, Kodovjat, Skëndërbegas, Kushovë, Tunjë dhe Sult. Ajo kufizohet nga bashkitë e Elbasanit dhe Përrenjasit në Veri, nga bashkitë Pogradec dhe Maliq në Lindje, nga Skrapari në Jug, dhe nga bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik në Perëndim. Bashkia Gramsh ka lidhje relativisht të mira me bashkitë e tjera përmes rrugëve interurbane.

Distancat më të favorshme me qytetet kryesore janë:

- Tiranë, 83.3 km, 1 orë dhe 43 minuta- Përmes rrugës Autostradës Tiranë- Elbasan, dhe me pas duke ndjekur rrugë interurbane.
- Durrës, 99.8 km, 1 orë dhe 55 minuta- Duke ndjekur rrugën nga Kavajë- Rrogozhinë- Cërrik.
- Elbasan, 44.2 km, 1 orë.
- Fier, 108 km, 2-re
- Vlorë, 144 km, 2 orë e 36 minuta.
- Lushnje, 80.1 km, 1 orë e 30 minuta
- Korçë, 83.3 km, 2 orë.

Bashkia Gramsh një bashki me standarte të mesem jetese e integruar mirë me rrjetet rrugore rajonale dhe kombëtare me zona të konsoliduara urbane dhe rurale të cilat kanë akses të mirë më njëra tjetrën. Bashkia Gramsh një bashki me ekonomi të zhvilluar dhe të bazuar në sektorin bujqësor blegtoral dhe në zhvillimet turistike, por edhe në sektorin e shërbimeve dhe atë industrial.

Strategjia për zhvillimin e Gramshit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. Këto janë themele të forta, të cilat garantojnë që i gjithë komuniteti të përfitojë sot, duke iu trashëguar njëkohësisht brezave të ardhshëm një territor e mjedis të shëndetshëm e të vetëipërtëritshëm, krahas zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm.

Urbanizimi është një proces dinamik por i kontrolluar e me ritje graduale në Gramsh. Ai fokusohet në forcimin dhe konsolidimin e qendrave ekzistuese si dhe shfrytëzimin e drejtë të hapësirave publike dhe orientimin drejt qendërve urbane të zhvillimit. Në këtë mënyrë shërbimet sillen më afër komunitetit, në mënyrë efikase nga pikëpamja ekonomike dhe mbi të gjitha, krijohet një klimë e shëndetshme për biznesin, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë. Përmes fuqizimit të ekonomisë rurale së saj, Bashkia Gramsh synon të konsolidojë profilin si po rajonal i zhvillimit ekonomik turistik dhe bujqësor, duke u bërë konkurrues në nivel vendi dhe më gjerë. Duke u mbështetur tek parimet e subsidiaritetit, synohet përfundimisht i një rrjeti shumë-qëndërsish në territor, të decentralizuara si pole të zhvillimit ekonomik dhe administrativ. Këto qendra të përbëra nga vendbanime cilësore dhe aktivitete ekonomike plotësuese brenda rrjetit, kulmojnë me qytetin e Gramshit, ku fokusohet shumica e aktiviteteve urbane dhe e shërbimeve publike e komunitare.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë / Këshillit të Qarkut

Me qëllim konkretizimin e strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Gramsh, Vizioni i bashkisë është zbërthyer dhe detajuar më tej në objektiva Strategjike (4) dhe Programe strategjike të zhvillimit. Në këtë mënyrë Bashkia e Gramshit do të mundet të arrijë më lehtë objektivat e saj strategjik për 15 vitet e ardhshme, duke i lidhur në mënyrë direkte projektet strategjike të cilat impaktojnë drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social të saj.

Vizioni i Bashkisë Gramsh mbështetet në 5 parime kryesore të cilat i shërbejnë thellimit të potencialeve aktuale të bashkisë Gramsh si dhe realizimit të zhvillimit të qëndrueshëm e aftëgjatë të territorit.

1. Diversifikimi dhe bashkëjetesa e sektorëve të ndryshëm ekonomikë: bujqësi, industri, turizëm dhe ofrimi i shërbimeve;
2. Mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore;
3. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit natyror dhe ujor;
4. Lidhja e territorit nëpërmjet akseve parësore automobilistike dhe dytësore peizazhistike/rekreative;
5. Përmirësimi i kushteve të jetesës nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë / Këshillit të Qarkut (1-2 faqe)

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të bashkisë gramsh në sektorin, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Zhvillimi i infrastrukturës rajonale për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të lëvizshmërisë, transportit, dhe shërbimeve të lidhura me infrastrukturën.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Menaxhim i qëndrueshëm njëditor në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementet e forta natyrore dhe artificiale, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmi rësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, si dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyt dhe Përfituesit

1. Ndërtimi një pike grumbullimi të produkteve bujqësore në hyrjen jugore të qytetit
2. Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në hyrjen jugore të qytetit
3. Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh
4. Projekti për ndërtimin e bujtinave në zonat turistike të bashkisë Gramsh (Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabove, Liq i Dushkut)
5. Restaurimi i bllokut qëndror të banimit në qytetin e Gramshit si një zone e cila ruan arkitekturën e kohës së diktaturës dhe zhvillimi i bizneseve të vogla me qëllim diversifikimin e veprimtarisë ekonomike të zonës.
6. Rehabilitimi dhe rigjenerimi i zonës së tregut aktual të perimeve në Gramsh
7. Rigjenerimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës ish-industriale në hyrje të qytetit dhe zhvillimi i saj si zonë shërbimesh tregtare punishtesh dhe si zonë banimi.
8. Zhvillimi i zonës së bulevardit të ri si zonë shërbimesh tregtare dhe banimi në të dy krahet e bulevardit
9. Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e disa seksioneve të rrugës orbitale Dushk-Sult-Sarasel-Jançe-Brasnik-Dumbreas-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur-Rrashtan-Gjerë-Holtas-Poroçan-Drizë.
10. Projekti për ndërtimin e By-Passit të qytetit në anën lindore të tij
11. Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacione të ndryshme nga qyteti në drejtim të destinacioneve turistike të bashkisë
12. Sistemimi dhe zgjerimi i terminalit të autobusëve në qytetin e Gramshit
13. Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit
14. Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit
15. Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave riparuese të lumit Devoll
16. Rikonstruksioni i shesheve të qendrave të njësisve administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishaj, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë

17. Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës

18. Projekti për ndërtimin e zonës rekreative të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll

O1P1: Rritja e performancës së sektorëve ekonomikë në bashkinë Gramsh, zhvillimi i sektorit të shërbimeve, si dhe zhvillimit të sektorëve bujqësorë blegtoralë e turistikë në zonat me karakter natyror.

Pr.1: Ndërtimi një pike grumbullimi të produkteve bujqësore hyrjen jugore të qytetit.

Pr.2: Ndërtimi i tregut të ri industrial në hyrjen jugore të qytetit.

Pr.3: Krijimi i një qendre agro-industriale për përpunimin, përgatitjen e prodhimeve në shkallë rrethi, si: produkte bujqësore dhe blegtorale në hyrjen jugore të qytetit.

Pr.4: Projekti për rehabilitimin dhe pastrimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese të parë dhe të dytë në të gjithë bashkinë Gramsh

Pr.5: Projekti për rehabilitimin e rezervuarëve ujitës të bashkisë Gramsh

Pr.6: Projekti për ndërtimin e bujtinave në zonat turistike të bashkisë Gramsh (Sotirë, Irmaj, Poroçan, Kukur, Grabovë, Liq i Dushkut)

Pr.7: Projekti për krijimin e ofertave turistike të bashkisë Gramsh si dhe marketimi e brandingimi i tyre në funksion të zhvillimit të sektorit të turizmit

O1P2: Përmirësimi i klimës së biznesit të vogël nëpërmjet politikave nxitëse dhe sigurimit të infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse të tyre

Pr.1: Mbështetja e zhvillimit të bizneseve të vogla artizanale në zonat ekonomike me karakter tregtar.

O2P1: Konsolidimi i lidhjeve të bashkisë së Gramshit në nivel rajonal, duke siguruar integrimin me rrjetet shtetërore rrugore.

Pr.1: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Elbasan-Gjinar-Zavlinë Poroçan-Kukur-Lenie-Strelcë

Pr.2: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh -Tunjë -Jançë -Kostren-Roshnik-Berat

Pr.3: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Tunjë-Katërlis- Sarasel-Lumas

Pr.4: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh -Kukur- Përrenjas

Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjuhë-Dushk-Kutërçarë-Dragot-Mollas

O2P2: Përmirësimi i lidhjeve ndërqytetëse mes qendrave të njësive rurale me njëra-tjetrën dhe me Gramshin.

Pr.1: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e disa seksioneve të rrugës orbitale Dushk-Sult-Sarasel-Jançë-Brasnik-Dumbreës-Kushovë-Skenderbegas-Bratilë-Lenie-Grabovë-Gribë-Kukur- Rrashtan- Gjerë- Holtas-Poroçan-Drizë

Pr.2: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Lenie

Pr.3: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Fushërangës-Liras-Sinan-Tervol-Venizë-Broshtan-Posnovisht-Kishtë-Zmashë

Pr.4: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Çekin-Tervol

Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Bulçar- Liqeni i Dushkut (rruga e vjetër)

Pr.6: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Luzhe-Lubinje-Dufshan-Sult

Pr.7: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë- Dufshan

Pr.8: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Shëmrizë-Ostrenth

Pr.9: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Sotirë

Pr.10: Projekti për rehabilitimin dhe sistemimin e rrugës Gramsh-Trashovicë-Zgjuhë-Dushk-Banjë

O2P3: Sistemi i rrjeteve rrugore në nivel qyteti për të rritur nivelin e jetueshmërisë në qytet dhe zonat rurale.

Pr.1: Projekti për ndërtimin e By-Passit të qytetit në anën lindore të tij.

Pr.2: Projekti për ndërtimin e rrugës gjatsore përgjatë bregut të lumit Devoll.

Pr.3: Projekti për ndërtimin e zgjatimit të Bulevardit kryesor të qytetit.

Pr.4: Projekti për ndërtimin e rrugës nga Terminali deri në hyrje të By-Passit të ri të qytetit.

O2P4: Integrimi i bashkisë së Gramshit në tërësinë e itinerareve të gjelbra në nivel qyteti dhe në nivel rajonal nëpërmjet infrastrukturës së lehtë e turistike.

Pr.1: Krijimi i një rrjeti shtigjesh, të pajisur me sinjalistikën respektive dhe shërbimet ndihmëse, me destinacione të ndryshme nga qyteti në drejtim të destinacioneve turistike të bashkisë

Pr.2: Ndërtimi i korsive të biçikletave, kalimeve këmbësore përgjatë dhe shesheve si pika vrojtimi të natyrës përgjatë By-passit në anën lindore të qytetit.

Pr.3: Ndërtim i korsive të bicikletave dhe kalimeve këmbësore përgjatë lumit Devoll në pjesën e qytetit.

Pr.4: Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkallëve të qytetit përgjatë përrenjve si shoqëruese të elementeve natyrore duke stimuluar levizshmërinë e qendrueshme në qytet.

O2P5: Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, duke siguruar shërbim cilësor për të gjithë territorin e bashkisë

Pr.1: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimi i tubacioneve të reja të ujërave të zeza në NjA-të Sult, Pishaj, Kushovë, Kodovjat dhe Skenderbegas.

Pr.2: Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e gropave spetike si pas standrateve në fshatrat që nuk kanë akses në KUZ.

Pr.3: Projekti për ndërtimin e linjës së ujësejllsit në fshatrat Liras, Cërrunjë, Cigna, Nartë, Harunas, Duzhë, Silar, Taragjin dhe Kuratë

O2P6: Programi për përmirësimi i situatës së lëvizshmërisë dhe transportit publik në nivel bashkie.

Pr.1: Projekti për zhvillimin e një sistemi transporti publik brenda bashkisë për të siguruar aksesin së më të mirë të NjA-ve me qytetin e Gramshit

Pr.2: Sistemi dhe zgjerimi i terminalit të autobuzëve në qytetin e Gramshit.

Pr.3: Projekti për ndërtimin dhe rehabilitimin e vendqendrimëve të automjeteve kryejnë transportin rrethëqytetas në NjA-të e bashkisë Gramsh.

Pr.4: Projekti për ndërtimin e parkimeve të automjeteve në hyrje dhe dalje të qytetit si dhe në qendrat e NjA-ve.

Pr.5: Projekti për rehabilitimin dhe shtimin e ndricimit rrugorë në Qytetin e Gramshit dhe qendrat e NjA-ve të Bashkisë Gramsh.

O3P1: Menxhimi i integruar i mbetjeve urbane duke përfshirë strategjitë për mbledhjen e diferencuar dhe reduktimin e mbetjeve, zhvendosjen dhe rregullimin e vendit të depozitimit ekzistues për t'u përshtatur me kushte më sanitare, si dhe mundësitë e kryerjes së kompostimit të mbetjeve organike.

Pr.1: Hartimi i një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel bashkë me synim riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, si dhe blerja e automjeteve për transportimin e mbetjeve urbane.

Pr.2: Rehabilitimi mjedisor i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtim i sipas standardeve të pikës së transferimit të mbetjeve të ngurta.

Pr.3: Hartimi i një strategjie dhe sigurimi i kushteve fizike për kompostimin e mbetjeve organike si dhe ndërtimi i pikës së kompostimit të mbetjeve organike.

O3P2: Programi për krijimin e parqeve rajonale në zonat mjedisore që cilësohen si zona me biodiversitet të lartë duke mbrojtur dhe konservuar faunën dhe florën si dhe elementet e fortë natyror, peizazhistik, e historiko-kulturor.

Pr.1: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Kalasë së Irmajit.

Pr.2: Krijimi i parkut rajonal në zonën e Lenies dhe Kukurit.

O3P3: Rehabilitimi mjedisor i zonave ripariane të lumenjve përrenjve dhe zonave me rrezik natyror.

Pr.1: Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative të zonave ripariane të lumit Devoll.

Pr.2: Rehabilitimi mjedisor dhe marrja e masave për minimizimin e erozionit të tokave bujqësore përgjatë përroit të Tomorricës, Vërçës dhe Holtës.

Pr.3: Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumi Devoll dhe liqeni i Hidrocentralit të Banjës.

Pr.4: Ndërtimi i pritave malore dhe ndërmarrja e fushatave të mbjelljes së bimësisë për zbutjen e veprimtarisë së erozionit në zonat e zhveshura malore.

Pr.5: Projekti për pyllëzimin e kodrave në afërsi të lagjes Llapushaj në qytetin e Gramshit si dhe në zonën e Liqenit të Dushkut.

O4P1: Rikonstruksioni i objekteve arsimore shëndetësore dhe me funksione publike me probleme fizike, si dhe përshtatja e mjediseve për të plotësuar kërkesat, kapacitetet dhe standardet.

Pr.1: Rikonstruksioni i shkollave 9-vjeçare në fshatrat, Nartë, Holtas, Gjerë etj.

Pr.2: Ndërtimi i shkollave 9-vjeçare në fshatrat Kukuçovë, Zgjupë, Kabash dhe Lleshaj.

Pr.3: Përmirësimi i kushteve laboratorike dhe sportive të objekteve arsimore 9-vjeçare dhe të mesme në bashki.

Pr.4: Rikonstruksioni i plotë i shkollës së mesme në Tunjë

Pr.5: Rikonstruksioni i ndërtesave publike të njësive administrative Kushovë dhe Sult

Pr.6: Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore në fshatrat Siman dhe Ermenjë si dhe ndërtimi i qendrës shëndetësore në fshatrat Bratille dhe Kokël.

O4P2: Rikonstruksioni i ndërtimi dhe rehabilitimi i shesheve kryesore në qytet dhe në qendrat e njësive administrative dhe fshatrave

Pr.1: Ndërtimi i sheshit në afërsi të kishës në zgjatimin e bulevardit të ri të qytetit.

Pr.2: Rikonstruksioni i shesheve të qendrave të njësive administrative Poroçan, Kukur, Lenie, Sult, Kushovë, Skenderbegas, Pishci, Tunjë, Kodovjat dhe fshatrat Grabovë, Sotirë

O4P3: Zhvillimi social-kulturor dhe sportiv i popullsisë duke rehabilituar infrastrukturën ekzistuese dhe duke shtuar objekte sociale e kulturore në shërbim të nevojave të komunitetit.

Pr.1: Projekti për rikonstruksionin i godinës së Komisarariatit Policor dhe kthimi në zyrë për shërbime administrative të institucionit të Bashkisë Gramsh.

Pr. 2: Projekti për rikonstrukcionin e bibliotekës së qytetit

Pr. 3: Projekti për rikonstrukcionin e muzeut të qytetit

Pr. 4: Projekti për rikonstrukcionin e Pallatit të Kulturës në qytet.

04P4: Zhvillimi i qëndrueshëm i hapësirave të lira në Gramsh, gjelbërimi dhe hapësirave me karakter të veçantë për t'i shërbyer funksionit mjedisor dhe estetik për qytetin.

Pr. 1: Projekti për rivitalizimin e bregut të Liqenit të Banjës

Pr. 2: Projekti për ndërtimin e zonës rekreative të qytetit në fushën e bregut të Lumit Devoll

Pr. 3: Projekti për ndërtimin e parkut tërthor të qytetit i cili lidh parkun e bregut të lumit me zonën e kodrave në pjesën lindore të qytetit.

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GRAMSH 2024-2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë GRAMSH gjatë periudhës 2024-2026, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nën seksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2024-2026, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nën seksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2024-2026. Ky nën seksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë GRAMSH

(B1) Informacioni Përgjithshëm

VITE	2021
VITE	2022
VITE	2023
VITE	2024
VITE	2025
VITE	2026

Emri (Eni)	BASHKIA GRAMSH
Shënim për qatërimin e funksionimit	AFRIM SHYLLA
Kontraktuesi	SHESH KAMBER DERMYSHI
Kontrakti	3301
Adresa	Gramsh
Datë e ardhurave të fundit	2020.02.15
Popullsia administrative pas bashkimit	36,000

Monedha	1'000 LEK
---------	-----------

	2019	2020	2021	2022	2023
10					
95					
739					
3					
736					
739					
193					
103					
93					
350					
34,980	34,785	34,683	34,556	34,527	
15,850	14,052	14,200	14,181	14,225	
19,130	20,733	20,483	20,375	20,302	
40	42	43	43	43	
154	128	135	124	119	
114	118	121	134	128	
402	443	425	428	426	
12,652	12,365	12,205	12,184	12,095	
3,385	3,327	3,300	3,291	3,215	
9,267	9,038	8,905	8,893	8,880	
329	336	353	353	355	
92	92	97	97	100	
237	244	256	256	255	
0	0	12	12	12	
0	0	0	0	0	
0	0	12	12	12	
20	19	18	14	14	

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë GRAMSH

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë GRAMSH për vitet 2024-2026

Kjo nën seksion paraqet një përshkrim të secilit prej burime kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të prishmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

DISA TREGUES TË RËNDËSISHËM PËR BUXHETIN :

- Të ardhurat e veta vendore per vitet 2024-2026, zënë mesatarisht 24.5. % të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtëzuar per vitet 2024-2026 zënë mesatarisht 41.3 % të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale per vitet 2024-2026 zë mesatarisht 26.5 % të totalit të buxhetit.
- Burimet nga te ardhurate trasheguara qe parashikohet per vitet 2023-2025 zë mesatarisht 0.7 % të totalit të buxhetit.
- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2024 është 277,499 mijë lekë dhe zë 41.3 % të totalit të shpenzimeve , per vitin 2025 është planifikuar 285,772 mijë lekë dhe ze 41.2 % te shpenzimeve dhe per vitin 2026 është planifikuar 294,345 mijë lekë dhe ze 41.1 % të totalit të shpenzimeve dhe zënë mesatarisht 41.2% të totalit të shpenzimeve.
- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2024 është 193,884 mijë lekë, per vitin 2025 është planifikuar 199,701 mijë lekë dhe per vitin 2026 është planifikuar 205,692 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 28.9 % të totalit të shpenzimeve .
- Totali i shpenzimeve kapitale per vitin 2024 është planifikuar 199,920 mijë lekë, per vitin 2025 jane planifikuar 207,500 mijë lekë dhe ne vitin 2026 jane planifikuar 213,800 mijë lekë, mesatarisht zene 29.9 % te shpenzimeve totali.

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë GRAMSH

Ky nën seksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore të parashikuara për tu mbledhur nga bashkia Gramsh për periudhën 2024-2025 përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat 1 72,000 m², taksa mbi tokën bujqësore 103 km², dhe taksa mbi truallin 173,000 m², si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 23,000 m²; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier për afersisht 60 shtreter hotelier; ç) taksa e tabelës 20m²; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

- tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj, Tarifa keto të cilat do të mbidhen perkundrejt ofrimit të shërbimeve të lartepërmendura për 12,095 familje, 426 bizneseve, 634 femije në kopshte/cerdhe si dhe tarifa për parkingjeve private; f) tarifa për linjat ajrore dhe nentokesore, janë parashikuar tarifat ajrore për 7 hidrocentraleve me kapacitet të vogël dhe 2 subjekteve të shërbimit të internetit në periudhën 2024-2026 është parashikuar një rritje e kësaj tarife mbështetur në pritshmerinë e mbledhjes së deturimeve për tarifën e prapambetura për subjektet e shërbimit të internetit, me të cilat jemi në proces gjyqësor dhe në ritjen e kërkesave për ndertime të reja të hidrocentraleve të vegjël në rrethet tona.

B. Të Ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta. Konkretnisht Bashkia Gramsh ka leshuar licenca për përdorimin e hapësirave bujqësore me 112 subjekte ose për 102 Ha si dhe ka nënshkruar kontrata për lejen me qira të 48 pronave në administratë.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë bashkia Gramsh është aksionere në "Ujesjellesi Gramsh S.H.A" subjekti mbi të cilin nuk janë parashikuar të ardhura nga dividendet nisur nga historiku financiar disa vjecar i kesaj ndermarrje; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

4.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë. Bashkia Gramsh ka perafersisht 1050 automjete të regjistruara 85% e të cilave janë me të vjetra se 10 vjet.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 përqind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Vitet	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Transferta e pakushtëzuar	257,193	272,601	291,059	311,168

Referuar shtojces 1 të Udhëzimit Nr. 6, datë 28.02.2023. të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026".

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësuës të Përgatitjes së PBA-së.

